



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

SIGURIA E MJEKËVE, NDRYSHIME NË KODIN PENAL

PROGRAMI I 300 QENDRËN SHËNDETËSORE

ZGJEROHET TASK-FORCA PËR KONTROLLIN E BARNAVE

PAKETA E KATARAKTIT, NDËRHYRJA DHE LENTET FALAS PËR QYTETARËT

MJEKË SPECIALISTË NË SPITALIN E KUÇOVËS

SHËRBIME DENTARE FALAS PËR KATEGORITË NË NEVOJË

FONDI SOCIAL, ZGJEROHEN SHËRBIMET SOCIALE NË TERRITOR

DITARI JAVOR

25-31 Mars 2019

Më shumë mbrojtje për profesionistët e shëndetit, me ndryshimin e Kodit Penal, që do të ashpësojë masat në rast të kanosjes dhe goditjes së personelit shëndetësor për shkak të detyrës. Po rishikohet edhe përcaktimi i gabimit mjekësor. Propozimet u diskutuan në tryezën e përbashkët mes kryeministrit Edi Rama, ministres Ogerta Manastirliu, me profesionistët e shëndetit.

Qendra Shëndetësore nr. 6 në Durrës ofron një standard të ri shërbimi jo vetëm për 20 mijë banorët e zonës së plazhit, por edhe për turistët. Me programin e 300 qendrave shëndetësore, vijon rehabilitimi i qendrave të kujdesit parësor nga veriu në jug të vendit. Ka përfunduar rehabilitimi edhe i qendrës shëndetësore Perlat në Mirditë, qendrës Kutalli në Urën Vajgurore, qendrës Derede në Krujë, ndërsa vijon puna për rehabilitimin e qendrës shëndetësore 24-orëshe të Vorës.

29 farmaci u gjobitën për shkelje, pas kontrollit të ushtruar nga Task-Forca për sigurinë e barnave. Për një kontroll sa më të plotë në të gjithë vendin, Task-Forca është zgjeruar, duke përfshirë anëtarë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Urdhëri i Farmacistëve të Shqipërisë, Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Barnave, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor.

Në Qendrën Spitalore Universitare dhe në Spitalin Rajonal të Vlorës, që prej Janarit të vitit 2019 janë kryer 427 ndërhyrje të kataraktit, duke përfshirë edhe lentet falas për pacientët e operuar. Nga kjo paketë shëndetësore përfitojnë rreth 2200 qytetarë në vit.

Punësohen tre mjekë specialistë në spitalin e Kuçovës, duke rikthyer shërbime që më parë mungonin dhe duke siguruar shërbim të specializuar për qytetarët, afër vendbanimit. Spitali i Kuçovës, po investohet jo vetëm në infrastrukturë, por edhe në burime njerëzore. Tre mjeket specialiste në shërbimin e Peditrisë, Gjinekologjisë dhe Mjekësisë Interne janë tre prej 168 mjekëve specialistë që po punësohen në të gjithë spitalet rajonale dhe bashkiake.

Me investimin e kryer në Klinikën Stomatologjike Universitare, ofrohen shërbime dentare cilësore pa pagesë për kategoritë në nevojë. Përfitojnë fëmijë të komunitetit rom, të institucioneve të përkujdesit social, të moshuarit, personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, etj. 1400 fëmijë dhe 3800 të moshuar kanë përfituar shërbime dentare falas.

Me buxhetin e shtetit do të financohet ngritja dhe zgjerimi i shërbimeve sociale për gratë, fëmijët në vështirësi, të moshuarit dhe të gjithë kategoritë në nevojë, nëpërmjet Fondit Social, një mekanizëm i ri financiar që garanton shërbimet sociale në çdo bashki. Këto shërbime do të financohen nga Fondi Social, në vitin e parë me 90 % të financimit, vitin e dytë 60 % të financimit, vitin e tretë 30% të financimit, në mënyrë që të rritet angazhimi i strukturave vendore për mbështetjen e shërbimeve sociale.